



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:069097

Datë: 20.05.2022

Numri i dokumentit: 03037740

PKR.nr.63/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me Kryetaren e trupit gjykues - gjyqtaren Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.D nga V K-Peje, shkak veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par.1 te KPRK-se, dhe vepër penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve substanca psikotrope ose analoge nga neni 269 prg 1 te KPRK-se, dhe të akuzuarës G. T nga P për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve substanca psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK, të akuzuar sipas aktakuzës së prokurorisë PP/I.nr.231/22 dt.12.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj të akuzuarit F.D dhe të akuzuarës G.T, me dt. 17.05.2022 mori dhe publikisht shpalli, dhe me dt.20.05.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.F D i biri i Enver dhe nënës L e gjinisë M i lindur me dt. ne P, tani me banim ne fshatin V K- Peje, posedon telefon me numër, i, ka te kryer shkollën e mesme, punon si, i gjendjes se mesme ekonomike, identifikuar ne baze te letërnjoftimit me nr. Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

2.G. T e bija e H dhe nënës S e gjinisë Zh, e lindur me dt. ne I, tani me banim ne P....., posedon telefon me numër, e, ka te kryer s shkollën e mesme, punon agjente telefonues, e gjendjes se mesme ekonomike, identifikuar ne baze te letërnjoftimit me nr. Shqiptare, Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

për shkak se:

1.I akuzuari F. D

I. Më parë dhe gjerë me datë 23.06.2021, rreth orës 21:45, në rrugën “B. B” në P, i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar, dhe atë: një pistoletë të llojit “C.Z”, model V70, me ngjyrë të zezë, me nr. serik, një karikator me kapacitet prej 8 (tetë) fishek, gjersa ka pas në posedim 7 (shtatë)

fishek të cal.7.65x17mm si dhe një thikë prej 8 cm, në atë mënyrë që, natën kritike përderisa Njësi i DHTN-së ishte në zbatim të Urdhëresës me nr. UGJK.Nr.20/21 ka vëzhguar dhe ka identifikuar veturën e llojit “B” me targa ..-...-...me drejtues te pandehurin dhe pas ndalimit nga policia të njëjtë në një çantë krahu i gjejnë armët me pjesët tjera përcjellëse te përshkruara si me lartë, ku të njëjtat i sekuestrojnë dhe pas ekzaminimit kanë dal me karakteristika te përshkruara si me lart.

- me çka ka kryer veprë penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”** nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

II. Me datë 23.06.2021, rreth orës 21:45, tek rrethi te pompa “K” në P, i pandehuri posedon substance narkotike te llojit kokainë te vendosur në një qese plastmasi, në atë mënyrë që, natën kritike përderisa Njësi i DHTN-së ishte në zbatim te Urdhëresës nr. UGJK.Nr.20/21 te lëshuar nga ana e Gjykatës, duke vëzhguar ka identifikuar veturën e llojit “B” me targa ..-...-...me drejtues te pandehurin F D., ku ky i fundit identifikohet duke marr sasinë e substancës nga personi me iniciale B.P. i cili ka qenë nën vëzhgim sipas Urdhëresës me numër si me lart, ku me pas me te vërejt se janë në përcjellje te policisë, qesen me kokainë ja merr e pandehura G duke e vendosur në çantën e krahut, e qe paraprakisht e njëjta kishte në posedim personal edhe një qese plastmasi me te njëjtën substance, e te cilat më pas i janë sekuestruar dhe pas ekzaminimit kanë rezultuar te llojit kokainë e në peshë neto prej 1.09 gram,

- me çka ka kryer veprë penale **“Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”** nga neni 269 par 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

2. E akuzuara G. T

III. Më datë 23.06.2021, rreth orës 21:45, në rrugën “B. B” në Pejë, e pandehura posedon substancë narkotike e llojit kokainë në peshë neto prej 1.09 gram, në atë mënyrë që, natën kritike përderisa Njësi i DHTN-së ishte në zbatim te Urdhëresës nr. UGJK.Nr.20/21 te lëshuar nga ana e Gjykatës, duke vëzhguar ka identifikuar veturën e llojit „.....”, me targa me drejtues te pandehurin F. D gjersa e pandehura ishte në ulësen e pasagjerit, ku pas ndalimit nga policia të pandehurit i gjejnë armët te përshkruara si në disp. Nr. I ndërsa te pandehurës G i gjejnë substancën narkotike te llojit si me lart te vendosur në dy qese plastmasi në çantën e krahut, e cila më pas është sekuestruar dhe pas ekzaminimit ka rezultuar si e llojit dhe sasisë të përshkruar si më lartë,

- me çka ka kryer veprë penale **“Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”** nga neni 269 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj , gjykata konform nenit 7,17 par.1,38,39,40,43, nenit 69, 70,76, nenit 366 par.1, 269 par 2 lidhur me par 1 te KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPRK-së, të akuzuarit:

I GJYKON

1.Te akuzuarin F. D

Për veprë penale si në dispozitivin e parë të cekur më lartë, me dënim me gjobë në shumë prej 500€ (pesëqind euro).

Për vepër penale si në dispozitivin e dytë të cekur më lartë, me dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind euro).

Konform nenit 76 par. 2 pika 2.4 të KPRK-së të akuzuarit i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumën prej 1000 € (njëmijë euro).

Këtë dënim obligohet ta paguaj më së largu në afat prej 5 muaj nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe atë me 5 këste.

I akuzuari duhet të paguaj këstin në shumë prej 200€ (njëqind euro) me datën 1 (një) të muajit. Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan këstin me kohë atëherë të njëjtit mundësia e pagesës me këste do ti revokohet dhe i akuzuari obligohet të paguaj gjobën në tërësi.

Nëse i akuzuari i lartcekur, dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj, gjykata do ti zëvendësoj pjesën e mbetur të gjobës në dënim me burgim, duke ju llogaritur 20€ (njëzet euro) një ditë burg.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro), si dhe shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Te akuzuarit F. D i konfiskohet arma një pistoletë të llojit "C.Z", model ..., me ngjyrë të zezë, me nr. serik, një karikator me kapacitet prej 8 (tetë) fishek, gjersa ka pas në posedim 7 (shtatë) fishek të cal.7.65x17mm si dhe një thikë prej 8 cm.

2. Te akuzuarën G. T

Për vepër penale si në dispozitivin e tretë të cekur më lartë, me dënim me gjobë në shumë prej 500€ (pesë qind euro).

Këtë dënim obligohet ta paguaj më së largu në afat prej 5 muaj nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe atë me 5 këste.

E akuzuara duhet të paguaj këstin në shumë prej 100€ (njëqind euro) me datën 1 (një) të muajit. Në qoftë se e akuzuara nuk e paguan këstin me kohë atëherë të njëjtës mundësia e pagesës me këste do ti revokohet dhe e akuzuara obligohet të paguaj gjobën në tërësi.

Nëse e akuzuara e lartcekur, dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj, gjykata do ti zëvendësoj pjesën e mbetur të gjobës në dënim me burgim, duke ju llogaritur 20€ (njëzet euro) një ditë burg.

Obligohet e akuzuara që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro), si dhe shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarve F.D dhe G. T u konfiskohet substanca narkotike e llojit kokainë në peshë neto prej 1.09 gram, që gjendet në ruajtje sipas rastit policorë-...., dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e njëjta do të shkatërrohet.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr. 231/22 të dt. 12.04.2022, kundër te akuzuarve: F. D nga V K-Peje, për shkak te veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par. 1 te KPRK-se, dhe vepër penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve substanca psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 te KPRK-se dhe G. T nga P për shkak te veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve substanca psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 te KPRK.

Para leximit te aktakuzës Prokurorja e shtetit bënë përmirësimin e të tre dispozitivave të aktakuzës ashtu që koha e kryerjes së veprës penale duhet të jetë 23.06.2021 si dhe sa i përket kualifikimit juridik të veprës penale për dispozitivin me numër rendor 2 për të akuzuarin F. D dhe veprës penale në raport me të akuzuarën G. T bënë rikualifikimin ashtu që për secilin vepra penale duhet të jetë: me çka ka kryer vepër penale “ Posedimi i pa autorizuar i narkotikeve, substanca psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 lidhur me par 1 te KPRK-se. Këtë përmirësim dhe plotësim e bënë mbi bazën se është bere një gabim teknik sa i përket vitit kalendarik si dhe sasia e substancës narkotike e llojit “ kokainë “ është me pak se 3 gram, dhe si rrjedhoje është bërë edhe plotësimin si me lart, gjersa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 17.05.2022, gjykata është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën dhe të drejtat e tyre dhe të akuzuarve ju ka dhënë mundësinë që të deklarohen për fajësinë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarit secilin veç e veç për rëndësinë dhe pasojat e pranimi të fajësisë.

I akuzuari F. D ka deklaruar se: ”- pasi që i kam kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimi të fajësisë të cilat më janë shpjeguar nga ana e gjykatës, deklaroi se e pranoj fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohem. Premtoi se nuk do ti përsëris”.

E akuzuara G T ka deklaruar se: “-pasi që i kam kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimi të fajësisë të cilat më janë shpjeguar nga ana e gjykatës, deklaroi se e pranoj fajin për veprën penale për te cilën akuzohem. E njëjta deklaroi se kërkoi falje vete vetes dhe fëmijëve te mi, kurrë me nuk do ta përsërisë ka qene kjo hera e pare dhe kam dashtë qe te provoi”.

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve ka deklaruar se: “-pajtohem me pranimin e fajësisë meqenëse një pranim i tillë është i bazuar ne shkresat e lendes, nga te njëjtit se cili veç e veç është bërë edhe paraprakisht pranimi i fajësisë, andaj

i propozoi gjykatës qe te beje pranimin e fajësisë meqenëse është i vullnetshme dhe pa presion”.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarve vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarve pasi që të njëjtit i kanë kuptuar pasojat dhe

përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave.

Gjykata i ka shpall fajtorë të akuzuarit bazuar në pranimin e fajësisë dhe provat që gjinden në shkresa të lëndës: Raporti të oficerit #6596 i datës 23.06.2021, Raporti i oficerit #4732 i datës 23.06.2021, Deklarata e të pandehurit F.D e dhënë në stacionin policor në Pejë me datë 23.06.2021 si dhe deklarata e dhënë pranë prokurorisë me datë 06.04.2022, Deklarata e të pandehurës G. T e dhënë në stacionin policor në Pejë me datë 23.06.2021 si dhe deklarata e dhënë pranë prokurorisë me datë 06.04.2022, Vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 24.06.2021, Fotografitë e realizuara nga policia, raporti i ekspertimit me nr. .../...-.../...-.... i datës 22.09.2021, Raporti i ekspertimit me nr. .../...-.../...-.... i datës 13.09.2021 si dhe CD-ja e siguruar nga vendi i ngjarjes si dhe shkresat tjera të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat për dënimin konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së për secilin veç e veç. Si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoj se i akuzuari F. D e ka pranuar fajësinë që në shqyrtim fillestarë, pendimin e tij dhe premtimin se nuk do të përsëriten veprime të tilla, nuk ka rrethana të njohura për gjykatën se më parë të ketë qenë i gjykuar, pastaj edhe rrethanat e tij familjare se është mbajtës i familjes babë i 2 fëmijë. E akuzuara G. T e ka pranuar fajësinë që në shqyrtim fillestarë, pendimin e saj dhe premtimin se nuk do të përsëriten veprime të tilla, nuk ka rrethana të njohura për gjykatën që më parë të ketë qenë e gjykuar, pastaj edhe rrethanat e saj familjare se është mbajtëse e familjes nënë e 2 fëmijëve. Nga rrethanat rënduese gjykata nuk ka gjete asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se dënimet më gjobë të shqiptuara janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë si dhe gjendjen e tyre ekonomike. Gjykata është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, siç është pengimi i të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, gjithnjë duke u bazuar nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata u ka mundur të akuzuarve pagesën e gjobës me këste konform nenit 43 par. 2 të KPRK-së.

Vendimin mbi konfiskimin gjykata ka vendosur bazuar në dispozitën e nenit 366 par.3 të KPRK-së dhe konform nenit 269 par. 3 të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 450 të akuzuarit secilin veç e veç i obligon në paguarjen e paushallit gjyqësorë.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit i obligoi të akuzuarit veç e veç që të paguajnë shumën e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**

2022:069097, 20.05.2022

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.